

FJALA E DEPUTETIT VULLNET SINAJ

E HËNË 11 PRILL 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Në radhë të parë, ju falënderoj për durimin që qëndruat deri në fund për të më dëgjuar! Problemi që dua të ngre sot, është sa i prekshëm, aq edhe delikat dhe prek të gjithë banorët e qytetit të Vlorës, të Selenicës, por edhe të të gjithë qarkut. Ka të bëjë me regjistrimin e pronave në qytetin e Vlorës, si dhe në të gjithë qarkun. Po t'i pyesësh disa njerëz që kanë probleme, shqetësime me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, apo ish-hipotekën, siç e quanim, dëgjon se ka të pakënaqur, ka vonesa, nuk punohet, ka probleme të pazgjidhura; thonë se ka edhe korrupsion. Mund edhe të ketë pasur raste të tilla më përpara, por unë nuk kam dalë këtu të mbroj asnjëri, por kam dalë të zbërthej situatën për të kuptuar të vërtetën dhe për të pasur mirëkuptimin e qytetarëve dhe të qeverisë për këtë problem. Ky shqetësim më ka ardhur në zyrën time.

Deri në vitin 2020 kërkesat për ASHK-në zinin rreth 35% të problemeve të përgjithshme, kurse vitet e fundit, 2021-2022, janë shtuar dhe zënë gati 80-90% të problemeve. Të gjitha këto më krijuan një shqetësim, të cilin e kam konstatuar edhe në takimet që kam bërë me banorët e Orikumit, të Panajasë, që kërkojnë certifikatat për shtëpitë para viteve '90, legalizimin e ndërtimeve të reja, regjistrimin e tokave bujqësore, shërbimet kadastrale. Të gjitha këto shqetësime më bënë që të zhvilloja një takim me drejtuesin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës në Vlorë, zotin Rinald Meta, për të cilin kam mendim shumë të mirë, sepse është një specialist i vërtetë dhe një person i përkushtuar në punë. Në takimin me të më tha se kërkesat janë shtuar përditë. Cila është arsyeja e shtimit të kërkesave të banorëve të qarkut të Vlorës për këto shërbime të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës? Unë mendoj se janë të gjitha investimet që ka bërë qeveria "Rama" në qarkun e Vlorës, është "Lungomare", është faza e dytë e "Lungomares", tuneli "Ujë i Ftohtë-Orikum", tuneli i Llogorasë, aeroporti i Vlorës, rruga e Lumit të Vlorës, rruga Peshkëpi-Selenicë, ai që nuk e keni parë akoma, "Sheshi i Flamurit", i cili besoj se do të dalë një gjë e bukur, sepse opozita e ka kritikuar edhe "Lungomaren".

Të gjitha këto investime kanë sjellë rritjen e interesit të qytetarëve për t'i zgjidhur problemet në ASHK. Nga takimi, që pata me drejtorin e ASHK-së, më tha se kapacitetet e ASHK-së së Vlorës në godinën ku ndodhet dhe me stafin e punës që ka, janë për të dhënë deri në 200 legalizime në muaj, por, nga ana tjetër, ka një kërkesë të jashtëzakonshme në rritje të qytetarëve për shërbime kadastrale: 200-300 kërkesa në ditë. Drejtori i mban punonjësit edhe pasdite për të punuar; edhe ditëve të shtuna, që janë pushim, me qëllim që t'u përgjigjen qytetarëve përditë. Problemi është: çfarë duhet të bëjmë? A mjafton kaq? Jo, nuk mjafton. Gjej rastin t'u them qytetarëve se duhet të jenë të vetëdijshëm që për plotësimin

e një dosjeje legalizimi kërkohen 60 ditë; për të dhënë një përgjigje të një shërbimi kadastral kërkohen 10 ditë, sepse janë procedura që zgjasin.

Nga ana tjetër, dua t'i sugjeroj qeverisë se për zgjedhjen e këtij problemi ka ardhur koha që ta spostojmë ASHK-në në një godinë tjetër, ka ardhur koha të rritim numrin e punonjësve, që punojnë në sektorin e legalizimeve, për të rritur numrin e legalizimeve në muaj, nga 200 ta çojmë në 400, 600. Në fund fare, dua ta mbyll fjalën time me një thënie të një ekonomisti austriak Ludwig von Mises, i cili thotë: "Historia na mëson se prona private është e lidhur ngushtë me qytetërimin". Le të japim kontributin tonë që ky qytetërim të forcohet dhe të modernizohet. Faleminderit!